

KONTAKTI



Rr. Shkodra, nr.6
10000 Prishtina, Kosovo



info@akk-ks.org



+383 38 200 10 734
+383 (0) 38 518-907
(0) 38 200 10-716



www.akk-ks.org



Korrupsioni mbaron me ndihmën tuaj...

0800 10 800

**Thirrjet janë pa pagesë,
konfidenciale dhe të besueshme!**

Ky grant mbështetet nga Programi i Shoqërisë Civile për Shqipërinë dhe Kosovën, financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme e Norvegjisë dhe e menaxhuar nga Fondacioni Kosovar i Shoqërisë Civile (KCSF) në partneritet me Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim (PA). Përmbajtja dhe rekomandimet nuk përfaqësojnë qëndrimin zyrtar të Ministrisë Norvegjeze të Punëve të Jashtme dhe Fondacionit Kosovar të Shoqërisë Civile (KCSF).



Advocacy Center
for Democratic Culture



Norwegian Embassy



**AGJENCIA KUNDËR
KORRUPSIONIT
(AKK)**



FONDACIONI KOSOVAR PËR SHOQËRI CIVILE
KOSOVAR CIVIL SOCIETY FOUNDATION

Anti-Corruption Agency
Агенција против корупције



RRETH AGJENCISË KUNDËR KORRUPSIONIT

Agjencia Kosovare Kundër Korrupsionit është organ i pavarur dhe i specializuar për zbatimin e politikave shtetërore për luftimin dhe parandalimin e korrupsionit në Kosovë.

AKK e zbaton mandatin e saj bazuar në:

Ligjin Nr. 03/L-159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit;

Ligji Nr. 04-L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë së Zyrtarëve të Lartë Publik dhe për Deklarimin, Origjinën dhe kontrollin e dhuratave të të gjithë zyrtarëve publikë;

Ligji Nr. 04/L-228 për Plotësimin-Ndryshimin e Ligjit Nr. 04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë së Zyrtarëve të Lartë Publik dhe për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave të të gjithë Zyrtarëve Publikë;

Ligji Nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Kryerjen e Funkcionit Publik;

Ligji Nr. 06/I-085 për Mbrojtjen e Denoncuesëve.

Ligji aktual Kundër Korrupsionit, në bazë të të cilit AKK zhvillon aktivitetet e saj, parashikon masa kundër korrupsionit në kuadër të aktiviteteve kundër korrupsionit, veçanërisht në hetimin fillestar të korrupsionit, mbrojtjen e denoncuesëve, analizimin dhe eliminimin e shkaqeve të korrupsionit, papajtueshmërinë, të mbajtjes së funksioneve publike dhe të kryerjes së veprimtarive fitimprurëse nga personat zyrtarë, kufizimet në pranimin e dhuratave në lidhje me kryerjen e detyrave zyrtare, monitorimin e pasurisë së tyre, si dhe të personave në lidhje të ngushtë me ta dhe kufizimet për subjektet kontraktore për pjesëmarrjen në tenderët publikë.



Zbatimi i ligjit është një nga tri shtyllat kryesore që mbështesin punën strategjike të Agjencisë.

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT KA PËRGJEGJËSITË E MËPOSHTME:



Zbatimi i kornizës ligjore në fushën e antikorrupsionit;



Rezultatet nga procesi i deklarimit të pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë dhe regjistrimi i dhuratave të marra, publikimi i regjistrave të formularëve të deklarimit të pasurisë të deklaruar nga zyrtarët e lartë publikë në faqen zyrtare të AKK-së;



Zhvillimi i procedurave paraprake të hetimit për rastet e dyshuara për korrupsion;



Parandalimi dhe trajtimi i rasteve të konfliktit të interesit gjatë dhe pas ushtrimit të funksionit publik të zyrtarëve të lartë publikë dhe zyrtarëve të tjerë;



Rezultatet e parandalimit të korrupsionit gjatë monitorimit të aktiviteteve të prokurimit publik;



Zbatimi i ligjit dhe trajtimi i rasteve në fushën e mbrojtjes së denoncuesve;



Përcjellja e kallëzimeve penale në prokuroritë kompetente, përcjellja e kërkesave për fillimin e procedurës disiplinore për shkelje të dyshuara administrative;



Edukimi i zyrtarëve publikë dhe aktivitete ndërgjegjësuese për qytetarët mbi kornizën ligjore dhe mekanizmat aktual përgjegjës për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit.